



21.06.2007

Informacione përkatëse të ministrisë së mbrëndëshme mbi të drejtën e strehimit të të huajve (Bleiberechtsregelung IMK), si dhe vendimet ligjore të mara për të huajt në vitin 2007 mbi çështjet e kaluara (Gesetzliche Altfallregelung 2007).

Më datën 17.11.2006 është propozuar për të huaj ligji i quajtur: e drejta mbi strehim (Bleiberechtsregelung IMK). Gjithashtu parashikohet se në verën e vitit 2007 do të merren vendime nga ana ligjore (Gesetzliche Altfallregelung) mbi çështjet e kaluara, të bazuara këto në paragrafet e rinj mbi strehin (Aufenthaltsgesetz) §104 a dhe 104 b. Si rrjedhim parashikohet të hyjnë në fuqi dy ligje të ndryshme, të cilët duken pjesërisht si të njëjtë, por edhe një kuptim shumë të ndryshën kanë.

Me anë të kësaj shkrese dëshirojmë, këshillojmë, i informojmë dhe i japin guxim të gjithë meshkujve dhe femrave përkatëse, që të bëjnë një kërkesë për strehim për vete e tyre si dhe femije e tyre, n.q.s kanë, si dhe i ftojme të vijnë dhe te marrin këshillat e duhura!

E drejta mbi strehim (Bleiberechtsregelung IMK) është tani aktualisht në fuqi. Kjo e drejte nuk është ligj, i cili ka hyrë në fuqi, por është një vendi- propozim i marrë nga ana e ministrisë së brëndëshme të republikës federale dhe nuk merret i njëjtë parasysh në të gjitha krahinat e shtetit. Për këtë vendim të propozuar (Bleiberechtsregelung IMK), ministria e brëndëshme e Schleswig-Holstein- it vendosi më 17.11.2006 mënyrën se si ky vendim duhet të merret parasysh nga ana e dikasterit për çështjet e të huajve (Ausländerbehörde).

Vendimet nga ana ligjore mbi çështjet e kaluara (Gesetzliche Altfallregelung), do të thotë ndryshimi i ligjit. Kjo do të thotë se duhet të hyje në fuqi ligji mbi strehim (Aufenthaltsgesetz) dhe të merret parasysh në të gjithë territorin e shtetit të republikës federale. Edhe pse ky ligj, i cili mendohet se hyjë në fuqi në gushtin e 2007, ministria e mbrëndëshme e Schleswig- Holstein- it ka vendosur në datën 02.04.2007 se që nga kjo datë të gjithë personat, të cilët kanë nje leje- qendrim të përkohëshem (Duldung) të mos kthehen nga ana e shtetit në vendlindjet e tyre, gjë që ishte e mundësishme n.q.s plotësoheshin kushte e ligjit të mëparshëm. Këtyre personave duhet tu jepet e drejta e strehimit te perkohshem (Duldung), e cila është me afat deri më 30.09.2007, bazuar tek ligji § 60a neni 4.

Dita e skadimit të afatit si dhe titulli i leje- qëndrimit:

Të dyja këto pika bazohen tek dita, data përkatëse e skadimit të afatit. Për të drejtën mbi strehim (Bleiberechtsregelung IMK) është vendosur data 17.11.2006 si data e skadimit të afatit. Për çështjet e kaluara (Gesetzliche Altfallregelung) është vendosur data 01.07.2007, si afat skadimi. Vetëm ai person, i cili i ka plotësuar këto kushte në afatin e caktuar te sipërpërmendur, ka të drejtë të marri një leje- qëndrim (Aufenthaltserlaubnis) bazuar tek paragrafi 23 neni 1; ligji mbi leje- qëndrimin e përkohshëm.

N.q.s personi i cili deri në datën e skadimit të afatit të sipërmendur nuk është në gjendje që jetën e tij ta financojë vete, d.m.th pa ndihma nga ana e shtetit, si dhe n.q.s ai nuk ka njohuri të mjaftueshme mbi gjuhën, d.m.th nuk din ta flasë gjuhën gjermane, i jepet ketij personi deri me 30.09.2007 bazuar tek vendimi i të drejtes mbi strehim (Bleiberechtsregelung IMK) vetëm e drejta e përkohshme (Duldung). Kurse bazuar tek vendimi i marrë mbi çështjet e kaluara (Gesetzliche Altfallregelung) i takon këtij personi një leje- qendrin me afat të caktuar deri me 31.12.2009

(Aufenthaltserlaubnis) bazuar tek ligji § 104 a neni 1 (§ 104 a Abs. 1 AufenthG); ligji mbi leje-qendrimin e përkohshëm.

Afati për bërjen e kërkesës:

Afati i vertetë për bërjen e kërkesës, bazuar tek vendimi i të drejtës mbi strehim (Bleiberechtsregelung IMK) në Schleswig- Holstein ka mbaruar në datën 18 maj 2007. Por ministria e mbrëndëshme ka vendosur që dikasteret për të huaj (Ausländerbehörde) janë të detyruar ti pranojnë, akceptojë edhe kërkesat, të cilat bëhen edhe pas këtij afati. Kërkesën, bazuar tek vendimi mbi çështjet e kaluara (Gesetzliche Altfallregelung) keni mundësi ta bëni në atë kohë kur ky ligj të vendoset (të hyj në fuqi).

Ju mund të bëni një kërkesë për leje- qëndrim të përkohshëm bazuar tek vendimi i të drejtës për strehim (Bleiberechtsregelung IMK) dhe në të njëjtën kohë, për siguri, kërkesën për moskthim nga ana e shtetit në vendlindje, bazuar tek vendimi i datës 02.04.2007.

Nëqoftë se ju mendoni se keni shanse të merrni një leje- qëndrim- bëni kërkesën e duhur. Mos prisni dhe mos i besoni vendimit që do të hyej në fuqi në të ardhmen, bazuar tek vendimi mbi çështjet e kaluara (Gesetzliche Altfallregelung),

Patjetër në çdo rast: Gjithmonë kërkesa të bëhet me shkim!!!

Kërkoni ndihmë dhe merrni këshilla nga qëndrat përkatëse ose tek avokatja juaj mbrojtëse ose avokati mbrojtës.

Kushtet e domosdoshme më të rëndësishme mbi pranimin e një leje- qendrimi:

Periudha e qëndrimit:

Sipas leje- qëndrim të përkohshëm, bazuar tek vendimi i të drejtës mbi strehim (Bleiberechtsregelung IMK), duhet që një i rritur që prej datës 17.11.1999 deri më sot të ketë banuar pa shpëputje në republikën federale. Bazuar tek vendimi mbi çështjet e kaluara (Gesetzliche Altfallregelung) i vendosur me 01.07.1999.

Të rriturit me fëmijë të mitur krijojnë një familje. N.q.s të paktën një fëmijë është mbi tre vjeç dhe shkon në kopësht (çerdhe) ose në shkollë, duhet që një nga prinderit e këtij fëmijë, të ketë banuar pa shpëputje këtu në republikën federale që nga data 17.11.2000 dhe deri me sot. Bazuar kjo gjë tek vendimi mbi çështjet e kaluara (Gesetzliche Altfallregelung), vendosur më 01.07.2001, kjo është e vlefshme edhe kur fëmija është nën moshën tre vjeçare.

Të ardhurat personale (pagesa)

Një kusht shumë i rëndësishëm në lidhje me pranimin e kërkesës për marrjen e një leje- qëndrimi të përkohshëm, bazuar tek ligji mbi një leje- qëndrim të përkohshëm (Aufenthaltserlaubnis) bazuar tek paragrafi 23 neni 1, është sigurimi i pamvlarur, për kohë të gjatë i jetës nëpërmjet të ardhurave financiare personale. Kjo do të thotë se të ardhurat financiare- neto duhet të jenë pro pjestar familje aq ta larta si të paktën shuma : e qirasë së banesës plus tatimet e ndryshme p.sh. energjia elektrike dhe uji, plus nxehtësia plus shuma e të hollave- ndihme nga shteti (Arbeitslosengeld II). Gjithashtu duhet që sigurimi shëndetsor të jetë i siguruar. Kjo gjë është e mundur n.q.s jeni në mardhënje pune, ku paguani tatimin e parashikuar.

Nëpërmjet të drejtës, bazuar tek leje- qëndrimi (Aufenthaltserlaubnis) sipas paragrafit 23 neni 1 (§ 23 Abs. 1 AufenthG); ligji mbi leje- qëndrimin e përkohshëm, keni të drejtë sipas ligjit të mirri edhe të holla për fëmijë (Kindergeld). Këto të holla llogariten si të ardhura personale. Por ndihmat të holla që ju jepen nga shteti (Wohngeld) për qiranë, ndihma sociale (d.m.th kur shteti invenston për qiranë, ushqimin, sigurimin shëndetsor) si dhe ndihme sociale dhe asistencë nga shteti (Arbeitslosengeld II), të gjitha këto të holla nuk llogariten si të ardhura personale, të fituara vetë. Këtu përjashtohen vetëm raste të veçanta p.sh kur në familje ka fëmijë të mitur ose kur ju ndiqni një shkollë profesioni- zanati.

Në kërkim të një pune

N.q.s të ardhurat personale të familjes nuk mjaftojnë për investimin e jetës familjare nëpërmjet pagesës ose n.q.s ju nuk keni patur mundësi të gjeni një vend pune, ju mund të bëni kërkesën tek dikasteret për të huaj (Ausländerbehörde) për marrjen e nje leje- qëndrimi, shkak kërkimi i punësimit, (Duldung zur Arbeitssuche), bazuar tek vendimi i të drejtës për strehim (Bleiberechtsregelung IMK). Kjo gjë është e kufizuar deri më 30.09.2007 dhe ju keni kohë të kërkoni një pune deri në këtë datë.

(Vendimi mbi çështjet e kaluara (Gesetzliche Altfallregelung) leje-qëndrim (Aufenthaltserlaubnis) bazuar § 104 a ligji mbi leje- qëndrimin për të huajt, afat i kufizuar deri më 31.12.2009).

Kushte të tjera që duhet të plotësohen

Pjestarët e familjes duhet që të keni dijeni mbi gjuhën gjermane, duhet që ta flasin atë të paktën në një nivel të shkallës A 2 (d.th. jo si fillestarët). Gjithashtu verifikohet se sa të madhe e keni banesën, a është e mjaftueshme, dhe duhet të paraqitni një pashaportë (Pass) dhe të tjera.

Për do të jetë e vështirë?

Përrjashtohet sipas ligjit përkatës, personat të cilët janë të dënuar mbi 50 ditë pune ose n.q.s dikasteret e sigurimit shtetëror dyshojnë se mund të jeni "pjestar në një grupim terroristash". Probleme mund të keni edhe n.q.s ju nuk keni bërë përpjekjet e detyrueshme. P.sh. ka mundësi se dikasteri përkatës për të huaj mendon dhe ju akuzon se ju nuk jeni përpjekur sa duhet për nxjerrjen e pashaportës suaj. Kjo do të thotë se ju jeni munduar ti shmangeni kthimit nga ana e shtetit ose e keni penguar atë me qëllim, ju e keni gënjyer dikasterin për të huaj dhe jeni rregjistruar me një identitet falls etj. Megjithatë ju këshillojme ta bëni kërkesën – ka mundësi se problemet ju zgjidhen- mbase me ndihmen e vendimit mbi çështjet e kaluara (Gesetzliche Altfallregelung).

Ne ju këshillojme juve:

Bëni një kërkesë me shkrim tek dikasteri për çështjet e të huajve. Një fotokopje mbajeni komplet në dosjen private. Ju mund ta bëni kërkesën bazuar tek vendimi mbi çështjet e kaluara (Gesetzliche Altfallregelung) si për siguri kërkesën për moskthim nga e shtetit bazuar tek vendimi i datës 01.04.2007.

N.q.s ju mendoni se i keni shanset e mira për marrjen e të drejtës mbi leje- qëndrimin e perkohshëm- menjëherë bëjeni këtë kërkesë !

Mos keni shumë shpresë tek vendimi mbi çështjet e kaluara (Gesetzliche Altfallregelung) !

Nëse ju dëshironi ne mund t'ju këshillojmë- mund të na telefononi, ne jemi në gjëndje t'ju tregojmë një shoqatë kopetente në zonën ku ju ndodheni. Ne faqet e internetit ndodhet një listë përkatëse :

Për informacione me të shumta mund të kontaktoni tek adresat e mëposhtme :

INFONET

Bildungs- und Berufszugänge für Flüchtlinge

c/o Flüchtlingsrat Schleswig-Holstein e.V.

infonet@frsh.de

www.infonet-frsh.de

Telefon: 0431 - 240 59 09

Bündnis Bleiberecht Schleswig-Holstein

c/o Flüchtlingsrat Schleswig-Holstein e.V.

office@frsh.de

www.hiergeblieben.info

www.frsh.de

Telefon 0431 - 735 000



INFONET wird gefördert durch
das Bundesministerium für Arbeit und Soziales, den Europäischen Sozialfonds, das Land Schleswig-Holstein und PRO ASYL



Bundesministerium
für Arbeit und Soziales



PRO ASYL
Förderverein PRO ASYL e.V.

Flüchtlingsrat
Schleswig-Holstein e.V.

